
Pjesëmarrja rinore – çelësi i demokracisë



**Dokument mbi politikën shtetërore
Tetor 2019
Shkup**

Dokument i shkurtër mbi politikën

Pjesëmarrja rinore – çelësi i demokracisë

© 2019, Instituti për politikë evropiane – Shkup (EPI)

Autore: **Ardita Vejseli**

Instituti për politikë evropianë – EPI është përdorues u mbështetjes financiare të programit Civika mobilitas.

Përbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e plotë e Institutit për politikë evropiane – EPI dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se ai pasqyron këndvështrimet e Civika mobilitas, Agjencisë zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC) apo të organizatave që e zbatojnë.

Hyrje

Shtetet e Ballkanit perëndimor duhet të vetëdijesohen mbi rëndësinë e të rinjve. Si shtete të cilat përballen me “largimin e trurit”, ato duhet të krijojnë një mjedis mundësish dhe t’u kushtojnë vëmendje të drejtave të të rinjve. Të drejtat dhe pjesëmarrja e tyre në shoqëri duhet të jenë pjesë e prioriteteve të demokratizimit të shoqërisë në Ballkanin Perëndimor.

Një prej temave mbi të cilat u diskutua edhe në Samitin e procesit të Berlinit në Poznan¹ dhe në konferencën rimore të Kryesisë rumune me Këshillin e Bashkimit Evropian², ishin pikërisht problemet me të cilat përballen të rinjtë dhe mënyrat se si të përmirësohet pozita dhe mjedisi i tyre, por edhe të drejtat dhe pjesëmarrja e tyre në shoqëri në shtetet e Ballkanit Perëndimor. Samitet e procesit të Berlinit kontribuojnë dhe kanë rëndësi të madhe për bashkëpunimin rajonal të Ballkanit perëndimor, por gjithashtu për interesat e sigurisë dhe procesin gjithëpërfshirës të aderimit të shteteve. Pikërisht në Samitin e Vjenës të vitit 2015 u themelua Zyra rajonale e bashkëpunimit ronor³, e cila konsiderohet si një prej rezultateve më të suksesshme të këtij procesi. Nisur nga ky aspekt, prioritizimi i të drejtave të të rinjve dhe pjesëmarrja e tyre theksion edhe rolin dhe rëndësinë e tyre në proceset e harmonizimit me standartet evropiane dhe demokratizimit të shoqërisë.

Përcaktim i problematikës në nivel rajonal

Në të gjitha samitet e deritanishme pjesëmarrja rimore ka qenë një nga prioritetet kryesore sa i përket të rinjve. Në vitin 2016 në Samitin e Parisit dhe në vitin 2017 në Samitin e Triestës, paralelisht me forumet e tjera, mbaheshin edhe forume të të rinjve, ku problemet dhe të drejtat e të rinjve shtroheshin dhe diskutoheshin duke dhënë një numër të madh rekomandimesh. Konkluzionet e vitit 2016⁴ në fushën e pjesëmarrjes rimore ishin në drejtim të përforcimit të edukimit qytetar në kuadër të arsimit formal dhe atë joformal, si dhe mënyrës se si të zhvillohen dhe të vlerësohen këshillet nacionale rimore dhe roli i tyre si një urë lidhëse mes të rinjve dhe institucioneve. Gjithashtu, u theksua dhe roli i Shërbimit vullnetar të Evropës në promovimin e pjesëmarrjes qytetare dhe kontributin ndaj demokracisë, sundimit të

¹ The Berlin Process, Information and Resource Centre. <https://berlinprocess.info/about/#csf-poznan-2019>

² Romanian Presidency of the Council of the European Union. <https://www.romania2019.eu/event/how-to-respond-to-the-european-aspirations-of-young-people-in-the-western-balkans-conference/>

³ Vienna Western Balkans Summit 2015, “Joint Declaration of the Establishment of the Regional Youth Cooperation Office of the Western Balkans,” 2015, <https://berlinprocess.info/wp-content/uploads/2017/12/Joint-Declaration-on-the-establishment-of-the-Regional-Youth-Cooperation-Office-of-the-Western-Balkans.pdf>.

⁴ Paris Western Balkans Summit, “Conclusion by the Working Group of the Western Balkans Youth Conference,” July 4, 2016, <https://berlinprocess.info/wp-content/uploads/2017/11/Western-Balkans-Youth-Conference-Paris.-Conclusions-by-the-Working-Groups.pdf>.

ligjit dhe të drejtave themelore në Ballkanin perëndimor. Konkluzionet e vitit 2017⁵, nga ana tjetër, bëjnë të ditur se te të rinxjtë gjithnjë e më tepër rritet besimi se strukturat formale politike nuk kryejnë funksionin siç duhet dhe në momentin kur ata përballen me një sistem politik që nuk u përshtatet nevojave të tyre, e as përfaqëson qëndrimet e tyre, atëherë nuk kanë dëshirë për pjesëmarrje. Për këtë arsyre rekomandimi i tyre është se në programet shkollore duhet të integrohet edukimi qytetar, si një instrument i cili do të sigurojë zhvillimin e mendimit kritik.

Në vitin 2019, për herë të parë u përgatit një dokument i shkurtër mbi politikën⁶, duke u fokusuar në përshkrimin sa më të saktë të problematikave të të rinxve. Ashtu si dhe në vitet e kaluara, është theksuar mungesa e edukimit qytetar në sistemin arsimor. Gjatë procesit arsimor të rinxjtë rrallëherë marrin lëndë të detyruar mbi edukimin qytetar, gjë e cila shkakton mungesë aktivizmi, por edhe (mos)besim në rolin e tyre për të bërë ndryshime në shoqëri. Ekziston deri në një farë mase një kornizë ligjore e të rinxve për shtetet e rajonit, por shumica e ligjeve apo strategjive janë krijuar pro forma, nuk janë krejtësisht aktive apo funksionale ose institucionet nuk kanë kapacitet dhe fuqi të mjaftueshme politike për t'i implementuar. Gjithashtu, një pjesë veçanërisht e rëndësishme është vullnetarizmi i të rinxve, i cili mbetet në nivel të ulët, si pasojë e mungesës së edukimit qytetar, udhëzimeve mbi vullnetarizmin si një angazhim shoqëror dhe të kuptimit të përgjithshëm të tij si diçka e panevojshme. Në konkluzionet e Samitit në Poznan⁷ mbizotëron shqetësimi për mungesën e vazhdueshme të mundësive për të rinxjtë dhe theksohet se duhet të rriten përpjekjet për t'iu siguruar të rinxve mundësi për pjesëmarrje, ndërmarrësi dhe modernizim të sistemit arsimor.

Në konkluzionet⁸ e Konferencës së Kryesisë rumune me Këshillin e Bashkimit Evropian vihet theksi mbi punën rimore dhe nevojën që ajo të konsiderohet si profesion, pasi punonjësit e rinx janë pikërisht ata që mund të identifikojnë nga afër problemet e të rinxve, qofshin ato të papunësisë, mungesës së arsimit joformal apo formal. Arsimi posedon një vend të veçantë, si fushë së cilës i nevojiten reforma të thella, që të mund edhe vetëdija e të rinxve mbi nevojat e shoqërisë dhe pjesëmarrjes rimore të nisë që aty.

Diçka që mund të vihet re nga të gjitha diskutimet dhe rekomandimet është fakti se vit pas viti mbeten dilemat dhe nevojat e njëjtë: reformat në arsim dhe në kornizën ligjore të pjesëmarrjes rimore. Fakti se çdo vit mbesin pak a shumë problemet e njëjtë, na bën të ditur se reformat nuk bëhen me shpejtësinë e duhur, janë aq minore sa nuk vihet re ndikimi i tyre, apo nga ana tjetër se nuk janë zbatuar fare. Mirëpo, mbi të gjitha, gjëja më e rëndësishme që del nga e gjithë kjo është se nevojitet t'i kushtohet një kujdes më i madh zhvillimit të pjesëmarrjes rimore, ku ndërthuren një seri fushash.

⁵ Trieste Western Balkans Summit, "Conclusions of the Working Group of The Connecting Youth - Moving Forward EU Western Balkans Youth Forum," July 11, 2017, <https://berlinprocess.info/wp-content/uploads/2017/11/Youth-Forum-Trieste-conclusions-by-the-Working-Groups.pdf>.

⁶ Vejseli, A., "Civil Society and Youth Engagement in the Western Balkans" (Civil Society Forum of the Western Balkans, May 2019), <https://epi.org.mk/wp-content/uploads/2019/07/CSF-PB-05-19-full-6.pdf>.

⁷ Poznań Western Balkans Summit, "Chair's Conclusion," July 5, 2019, https://berlinprocess.info/wp-content/uploads/2019/07/chairs_conclusions.pdf.

⁸ Romanian Ministry of Foreign Affairs, "Main Conclusions and Recommendations Summarized by The Presidency of the Council of the European Union," May 28, 2019, https://www.premier.gov.pl/files/files/conclusions_wb_youth_final.pdf.

“Pjesëmarrja në jetën demokratike është më shumë se të votuarit në zgjedhje”

Ndonëse ekzistojnë dokumente politike dhe hulumtuese, gjithsesi përkufizimi i pjesëmarrjes rimore mbetet relativisht i vështirë, duke nisur nga fakti se kjo gjë ndërthur një seri aktivitetesh dhe fushash. Karta e rishqyrtuar evropiane mbi pjesëmarrjen e të rinjve në jetën lokale dhe rajonale⁹ përkufizon pjesëmarrjen si: “Pjesëmarrja në jetën demokratike është më shumë se të votuarit në zgjedhje, edhe pse ky është një element i rëndësishëm. Pjesëmarrja dhe përfshirja aktive qytetare do të thotë të pasurit e të drejtave, mundësive, hapësirës dhe instrumenteve dhe aty ku është e domosdoshme edhe mbështetjen për pjesëmarrje në vendime sipas të cilave mund të ketë ndikim dhe përfshirje në aktivitetet të cilat kontribuojnë në ndërtimin e një shoqërie më të mirë”.

Duke u bazuar te përkufizimi i mësipërm, pjesëmarrja rimore mund të ndahet edhe në pjesëmarrje qytetare dhe politike, ku kemi: dalja në zgjedhje, anëtarësi në parti politike, pjesëmarrje në pushtet lokal, pjesëmarrje gjatë krijimit të politikave shtetërore, në vullnetarizëm, në nënshkrimin e online-peticioneve, në aktivizmin për mjedisin jetësore etj. Pjesëmarrja rimore këtu përfshin edhe një hapësirë ku të rinjtë mund të shprehin qëndrimet dhe mendimet e tyre por edhe mundësitë që vendimmarrësit t'i marrin parasysh këto mendime dhe qëndrime, pasi vendimet që do të marrin duhet të jenë relevante për nevojat e të rinjve.

Pjesëmarrja është një element thelbësor i një shoqërie demokratike dhe nga ky aspekt duhet të nxitet dhe të promovohet si i tillë nga ana e pushteteve.

Pjesëmarrja rimore dhe mundësitë në Maqedoni

Në indeksin e zhvillimit ronor në Maqedoni¹⁰ theksohet se sipas Indeksit botëror të zhvillimit të të rinjve (të mbështetur nga Komonuelthi) të vitit 2016, Maqedonia, në krahasim me kategoritë e tjera ka rezultat më të dobët në kategorinë e pjesëmarrjes qytetare, nga 0,495 deri 1, duke marrë kështu vendin e 92 në botë. Sipas indeksit, 69,1 % e të rinjve nuk kanë hyrë në kontakt me përfaqësues të pushtetit, kurse vetëm 36% të komunave kanë siguruar mbështetje financiare për nxitje të pjesëmarrjes rimore.

Ndërsa vullnetarizmi është një aktivitet i cili, jo vetëm që i ndihmon komunitetit, por edhe të rinjve, pasi nëpërmjet aktiviteteve vullnetare ata marrin aftësi të dobishme për angazhimin e tyre të mëtutjeshëm shoqëror, njëkohësisht duke i bërë që të kalojnë kohën e tyre të lirë në një formë cilësore. Megjithatë, niveli i përfshirjes së të rinjve në aktivitete vullnetarizmi¹¹ mbetet i ulët, edhe pse në krahasim me vitin 2013, kur niveli ishte vetëm 12,8 %, në 2018 ai është rritur në 20 %. Ky mbetet një tregues i faktit se

⁹ Council of Europe, “Revised European Charter on the Participation of Young People in Local and Regional Life” (n.d.), <https://rm.coe.int/168071b4d6>.

¹⁰ А. Цеков, „Индекс за младински развој во Македонија. Извештај за 2018 година“ (Коалиција за младински развој СЕГА, 2018), https://www.imrm.mk/doc/publikacija_Index2018-web.pdf.

¹¹ Топузовска Латковиќ, М.; Борота Поповска, М.; Серафимовска, Е.; Старова, Н., „Студија за млади на Северна Македонија 2018-2019“ (Фондација Фридрих Еберт, 2019), <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/skopje/15292.pdf>.

aktivizmi vullnetar nuk është në nivel të kënaqshëm. Maqedonia posedon kornizë ligjore për vullnetarizmin¹², por megjithatë dukshmëria dhe promovimi i vullnetarizmit nuk është në nivelin e duhur që t'i nxitë të rinjtë për t'u angazhuar. Sipas rezultateve, 58,3%¹³ e të rinjve konsiderojnë se vullnetarizmi nuk promovohet mjaftueshëm në nivel lokal.

Një pjesë tjeter që poashtu ndikon mbi pjesëmarrjen e të rinjve janë këshillet lokale rimore, si organet më të rëndësishme nëpërmjet të cilave të rinjtë mund të kontribuojnë dhe të ndikojnë mbi vendimet të cilat merren në interesin e tyre. Në 53 % të komunave ekzistojnë këshille formale për të rinjtë, megjithatë ata përballen me një mori problemesh, gjë e cila përkëqëson akoma më shumë gjendjen e rëndë të të rinjve. Një nga hulumtimet e fundit¹⁴ ka ardhur në përfundim se shumica e këshillave nuk kanë faqe të tyre të internetet, apo në rast se kanë ato nuk përditësohen dhe nuk janë mjaft të aksesueshme për informacione. Gjithashtu, kuadrot joadekuante apo të pamjaftueshme të këtyre këshillave shkakton mosbesim te të rinjtë dhe mosfunkcionim të këshillave, pasi ata nuk arrijnë t'i plotësojnë realizojnë aktivitetet e nevojshme apo t'i plotësojnë nevojat e të rinjve.

Fakti se Ligji për organizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve¹⁵ ende nuk është votuar dhe figuron si një propozim-teks, ashtu si dhe ligji për punë rimore, bën të ditur se përpjekjet për të vendosur një kornizë ligjore për të drejtat e të rinjve nuk mjaftojnë, dhe nuk mjaftojnë as strategji dhe planet e veprimit që nuk zbatohen deri në fund, për të treguar rezultate të suksesshme. Duke marrë parasysh se rinia është ardhmëria, duhet punuar fort që të përmirësohet gjendja e tyre dhe të ulet niveli i papunësisë, paralelisht me krijimin e mundësive për zvogëlimin e "largimit të trurit".

¹² „Закон за волонтерство”, „Службен весник на Република Северна Македонија”, бр. 85/2007, 161/2008, 147/2015 § (n.d.), http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/trud_2017/pravilnici/16,11-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%92%D0%9E%D0%9B%D0%9E%D0%9D%D0%A2%D0%95%D0%A0%D0%A1%D0%A2%D0%92%D0%9E.pdf.

¹³ Цеков, „Индекс за младински развој во Македонија. Извештај за 2018 година”.

¹⁴ Ивановска, А.; Мојсовски, А.; Кацарска, С., „Младинска вработеност во Република Северна Македонија. Основна студија и препораки”, 2019, <https://drive.google.com/file/d/1y9KaN9Xg9iBupZ7P3hbvGfQrVUhQJXlk/view>.

¹⁵ „Предлог на закон за младинско учество и младински политики” (2019), <http://www.zakonzamladi.ams.gov.mk/nekategorizirano/predlog-na-zakon-za-mladinsko-uchestvo-i-mladinski-politiki/>.

Rekomandime

Meqenëse pjesëmarrja rimore është fushë ku ndërthuren shumë fusha të tjera, rekomandimet¹⁶ që u dhanë në Samitin në Poznan janë relevante për demokratizimin e shoqërisë, por edhe për harmonizimin e standardeve evropiane në shoqëritë e shteteve të Ballkanit perëndimor.

Rekomandimet theksojnë se:

- Nevojitet të fillohet me integrimin e edukimit qytetar në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë me fokus mbi zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve të nxënësve dhe studentëve për të diskutuar dhe për t'i përfshirë në lloje të ndryshme aktivitetetsh, njëkohësisht duke i trajnuar arsimtarët dhe profesorët mbi metodën e mbajtjes së mësimit.
- Nevojitet të reformohet korniza ligjore e të rinjve, në mënyrë që të jetë përfshirëse dhe të krijohet së bashku me të rinjtë, kurse ligjet që janë neglizhuar të mund të risillen me qëllim që të rinjve t'u mundësohet një e ardhme akoma më e mirë.

¹⁶ Vejseli, A., "Civil Society and Youth Engagement in the Western Balkans."